



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**  
**SENATI AKADEMIK**

Nr. 2126/13 Prot.

Tiranë, më 16.09 2025

**VENDIM**

Nr. 105 dt. 16.09. 2025

**“PËR**  
**MIRATIMIN E PËRCJELLJES SË DOSJES SË KANDIDATIT**  
**DR. ALKETA ÇAUSHI PËR FITIMIN E TITULLIT “PROFESOR I ASOCIUAR”**  
**PRANË KPPA-SË”**

Në zbatim të nenit 38, 61, 79 pika 7 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, kreut IV pika 1 dhe 2 të Vendimit nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, nenit 20, 27 të Statutit të UST-së, nenit 7 të Rregullores së UST-së, nenit 21 dhe 24 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, mbështetur në shkresën nr.1418/10 Prot., datë 24.06.2025 të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Lëvizjes “Përcjellje e dokumentacionit për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar” të Dr. Alketa Çaushti”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 16.09.2025,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë përcjelljen e dosjes së kandidates Dr. Alketa Çaushti për fitimin e titullit akademik “Profesor i Asociuar” pranë Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së.
2. Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik të vijojë me procedurat sipas kuadrit ligjor në fuqi.
3. Një kopje e këtij Vendimi i përcillet Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Dixhitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

Prof. Dr. Agron KASA

